

2019-12-12

I ri në Suedi?

Mirë se vini në njësinë e pritjes për nxënësit e sapoardhur

Njësia e pritjes do të jetë takimi i parë juaj dhe i fëmijës tuaj me shkollën suedeze. Jeni të mirëpritur këtu me fëmijën tuaj që është midis 6 dhe 15 vjeç dhe që ka ardhur kohëve të fundit në Suedi.

Në njësinë e pritjes, ne bëjmë një sondazh të njohurive shkollore të fëmijës suaj. Sondazhi më pas formon bazën për përshtatjen e arsimit me nevojat e fëmijës suaj. Ne ju ofrojmë gjithashtu, edhe ty si prind i sapoardhur informacione për shkollën dhe shoqërinë suedeze.

Ne do t'ju ndihmojmë me këtë

Sondazh të aftësive shkollore të fëmijës suaj

Introdukcion për shkollën suedeze

Zgjedhja e një shkolle për fëmijën tuaj

Kështu bëhet pranimi në shkollë

Jeni të mirëpritur tek ne menjëherë kur të keni mbërrirë në Suedi.

Gjatë takimit tonë të parë, ne pajisemi me informacione për sfondin shkollor të fëmijës suaj, cilat janë interesat e fëmijës suaj dhe çfarë prisni ju nga shkolla. Ne gjithashtu ofrojmë informacione se si të bëni një zgjedhje shkolle për fëmijën tuaj.

Atëherë fëmija juaj është i mirëpritur tek ne për sondazh të diturive. Anketa do të kombinohet me një introdukcion në shkollë dhe zgjat rreth dy javë. Kur sondazhi të përfundojë, ne do t'i shqyrtojmë rezultatet me ju dhe do t'ia dorzojmë atë shkollës së re të fëmijës suaj.

2019-12-12

Kontakt

Jeni të mirëpritur të na kontaktoni ose të na vizitoni:

Ekspedicioni: tel 031-365 47 70

Orari i telefonit: e hënë - e premte ora 8.00 - 16.00 jo të martën pas orës 14.00

e-post: mottagningsenheten@grundskola.goteborg.se

Adresa e vizitës:


Mottagningsenheten för nyanlända elever (Nya Ullevi)

Skånegatan 6

Stacioni më i afër i tramvajit: Ullevi Södra

Besökstider:

E hënë - e premte në orën 8.00 - 16.00 jo të martën pas kl. 14.00.



Hyrje



**Nya Ullevi
Idrottsarena**